

Data 29.12.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHEKRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“PJESË KËMBIMI GOMA DHE BATERI”**, i ndarë në lote si më poshtë vijon:

- **Loti i parë: “Pjesë këmbimi goma”**
- **Loti i dytë: “Pjesë këmbimi bateri”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash-34330000-9.

Loti i parë: “Pjesë këmbimi goma”: Goma për automjete të rënda / të lehta- 34350000-5;
Goma për automjete të lehta-34351000-2

Loti i dytë: “Pjesë këmbimi bateri”: Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash-34330000-9

VLERA E FONDIT LIMIT

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **20.997.178,66** (njëzet milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh, i ndarë në lote si më poshtë vijon:

- **Loti i parë: “Pjesë këmbimi goma”** me fond limit 16.585.605,33 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesë presje tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.
- **Loti i dytë: “Pjesë këmbimi bateri”** me fond limit 4.411.573,33 (katër milion e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre presje tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike nga struktura përgjegjëse dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

ARGUMENTIMI I KRITEREVE LOTI I PARË: "PJESË KËMBIMI GOMA"

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdëklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e pritshme e kontratës (vlerës së fondit limit të lotit të parë) që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:

... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar për lotin e parë, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e pritshme e kontratës (vlerës së fondit limit të lotit të parë) që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së pritshme të kontratës (vlerës së fondit limit të lotit të parë) që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit të parë, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete bere me kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit të parë , në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin

dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një ambient pune (oficinë) të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve të montimit të gomave në mjete.

Ambienti/ servisi duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë së Tiranës. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/ huapërdorjen/ qiramarrjen si më poshtë:

a. Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

b. Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje (e vlefshme).

c. Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje (e vlefshme).

Argumentimi: *Referuar preventivit te administruar ne dosjen e procedures është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet shërbimi për zëvendësimin dhe vendosjen e gomës, balancimin e gomës dhe shërbimin e konvergencës, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë që do të marrin përsipër kryerjen e këtyre shërbimeve duhet të kenë një ambient pune (oficinë) për realizimin e këtyre shërbimeve ç'ka do të sillte detyrimisht realizimin me sukses të këtyre shërbimeve.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryej shërbimin për zëvendësimin dhe vendosjen e gomave, balancimin e gomës dhe shërbimin e konvergencës, si dhe shërbimin e transportit të gomave dhe dorëzimin e mallrave/ produkteve pranë magazinës së Bashkisë Tiranë si dhe nga magazina e Bashkisë Tiranë në mjedisin ku do të realizohet shërbimi me shpenzimet e tij.

Argumentimi: *Referuar preventivit te administruar ne dosjen e procedures është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet shërbimi për zëvendësimin dhe vendosjen e gomës, balancimin e gomës dhe shërbimin e konvergencës, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të deklarojnë marrjen përsipër për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe gjithashtu edhe marrjen përsipër të realizimit të transportit të tyre pranë ambjenteve të Bashkisë Tiranë pas kryerjes së shërbimeve si më sipër cituar.*

Për sa më sipër,

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë makineri pajisje të nevojshme bashkekohore për realizimin e kontratës, si vijon:

- të paktën një konvergencë 3D të viteve të fundit.

- të ketë pajisjet e nevojshme të balancimit

Për të vërtetuar disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin provues fatura tatimore ose zhdoganimin apo cdo dokument tjetër që vërteton disponimin e këtyre makinerive. Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi apo cdo dokument tjetër që vërteton disponimin e këtyre makinerive).

Shënim: Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.4 do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë **duhet** të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes së njoftimit paraprak të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per këtë kriter).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**

Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve të punës sa me sipër cituar lind e nevojshme edhe disponimi i makinerive të kërkuara.

Pajisjet e mësipërme janë të domosdoshme për të kryer proceset sikundër janë zëvendësimi dhe vendosja e gomës, balancimi i gomës dhe shërbimi i konvergencës. 3D (të paktën 3D), kjo teteknologji është e viteve 2015 e lartë, kërkesë kjo referuar viteve të prodhimit të mjeteve (të rejtat) që kanë të nevojshme këtë teknologji. Duke ju referuar DST-së, AK-s i nevojitet montimi i gomave në automjetet përkatëse për këtë duhet minimumi një konvergencë mbas montimit të gomave në automjet.

Ky kriter lidhet ngushtë me aftësinë zbatuese për arsye se gomat do të montohen në automjetet përkatëse nga OE i shpallur fitues pa kosto shtesë, pasi të jenë bërë hyrje në magazinën e Bashkisë Tiranë.

AK përpara hartimit të kriterëve kualifikuese merr në konsideratë qëllimin dhe aktivitetet e objektit të kontratës, përdoruesit fundor dhe vendin e përdorimit të tyre dhe më pas testimit të tregut pasi ka vlerësuar kapacitetet e tregut dhe industrisë bën vlerësimin e avantazheve dhe dizavantazheve teknologjike që kanë impakt në zbatimin e kontratës dhe ndikimin tek kërkesat e përdoruesve fundor.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik të ketë në pronësi ose me qira minimumi një karroatrec, në rast se gomat dëmtohen dhe mjeti nuk lëviz.

- - Në rast se mjeti është në pronësi OE duhet të paraqesë- Certifikatë pronësie, dokument që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e

sigurimit), çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS), taksa vjetore, certifikatë transporti të leshuar nga Bashkia përkatëse që lejon transportin në territorin e kesaj bashkie, foto të mjetit..

- Në rast se mjetet janë me qera OE duhet të paraqesë, Kontratë qeraje noteriale të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, Certifikatë pronësie të qiradhënësit, dokument që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit), çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS), taksa vjetore, certifikatë transporti të leshuar nga Bashkia përkatëse që lejon transportin në territorin e kesaj bashkie, foto të mjetit.

Shënim: Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.5 do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar në vend të pare **duhet** të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes së njoftimit paraprak të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për këtë kriter).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.** Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve të punës sa me sipër cituar lëndë e nevojshme edhe disponimi i karrotrecit.

Ky mjet shërben në rastet kur gomat demtohen dhe mjeti nuk do të mund të lëvizë deri pranë servisit për kryerjen e zëvendësimit të tyre.

- Mjeti i mësipërm është i domosdoshëm duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj i shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që disponon Licencë për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1.

Argumentimi: Kjo license është kërkuar duke marrë shkas nga llojet e shërbimeve që do të ofrohen dhe konform VKM Nr 538 dt 26.05.2009 për “Licencat edhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” (e ndryshuar). Kjo lloj license mbulon shërbimet si më poshtë vijon ndër të cilat përfshihen edhe shërbimet objekt prokurimi:

"Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove", me kodin VII.3.B.1, ku përfshihen:

a) riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

b) riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

c) riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

ç) riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

d) blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkiove;

dh) mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

Duke ju referuar DST-së kërkohet që gomisteria/oficina të jetë e licensuar sipas Legjislacionit në RSH (Kategoria: Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor). Kërkesa e DST, pika 2.3.6 “Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që disponon Licencë për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1, është në përputhje dhe në proporcion me nevojat dhe aktivitetet e kontratës si dhe me qëllimin final të kësaj kontrate, pasi licenca VII.3.B.1, **Pika ç. i referohet pikërisht ”Riparim dhe mirëmbajtje e gomave”.**

2.3.7 Operatori ekonomik të jetë i pajisur me leje mjedisore Tipi C, kodi III.1 A

Argumentimi: “Leje e thjeshte mjedisore” me kodin III.1.A eshte kerkuar konform përcaktimeve të bëra në Lejet mjedisore të përcaktuara në 29 pika 1 e ligjit nr. Nr.10 431, datë 9.6.20 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që do të kryhet e, si dhe në mundësinë që ka kjo veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut.

Duke ju referuar DST- së kërkohet dhe montimi i gomave në automjetet përkatëse dhe për këtë arsye gomisteria/oficina duhet të jetë e paisur me leje mjedisore Tipi C LIGJ PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE Nr.10 463, datë 22.9.2011 Neni 3. Pika 30, “Mbetjet nga gomat e përdorura” janë mbetjet që krijohen kur gomat e vjetëruara, të dëmtuara janë zëvendësuar dhe kur automjetet arrijnë në fundin e jetës së tyre.

Kjo kërkesë është në proporcion me qëllimin e objektit të prokurimit. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Sipas ligjit të Prokurimit Publik në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi.

2.3.8 Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë/ broshurë të gomave**, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura duhet te markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt goma dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 5 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të gomave sipas tabelës së përgjithshme ku të specifikohen të dhënat si vijon:

N	Emërtimi i artikullit (gomës)	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Referenca, kodi i mallit	Numri i faqes në katalog	Standarti i Cilësisë ISO
----------	--------------------------------------	---------------	--------------	-------------------------------------	-----------------------------	---------------------------------	---------------------------------	---------------------------------

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo është një kërkesë e

domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **deklaratë mbi garancinë e gomave** se garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 40000 (dyzet mijë) km dhe gomat e motoçikletave jo më pak se 12000 km. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit osë cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë.

***Argumentimi:** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe të mbulohen demtimet brenda perjudhes se garancise. Kriteri i kerkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

***Argumentimi:** Kriteri për paraqitjen e ISO- 9001:2015 u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Çertifikatë duhet të jetë e lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të realizuar kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektit të kontratës.*

Kerkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit.

- ISO 9001:2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron manaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha

standarteve të cilësisë. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga Operatori Ekonomik, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit, planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit/shërbimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

Shënim:

1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.

2. PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT: Operatori ekonomik që do të ofertojë për më tepër se një Lot, duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike dhe financiare sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra se bashku.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I KRITEREVE LOTI I DYTË: "PJESË KËMBIMI BATERI"

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdëklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së pritshme të kontratës (vlerës së fondit limit lotit të dytë) që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

"Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

.... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe

të ulët monetar;”. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar për lotin e dytë, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së pritshme të kontratës (vlerës së fondit limit lotit të dytë) që prokurohet lëshuar nga autoriteti përkatës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

2.2.3 Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së pritshme të kontratës (vlerës së fondit limit të lotit të dytë) që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 3 dhe 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të lotit të parë, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të lotit të parë, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin

privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një ambjent pune (oficinë) të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve të montimit të baterive në mjete.

Ambienti/ servisi duhet të jetë brenda territorit të Bashkisë së Tiranës. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/ huapërdorjen/ qiramarrjen si më poshtë:

a. Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

b. Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje (e vlefshme).

c. Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje (e vlefshme).

Argumentimi: Referuar preventivit të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet shërbimi për zëvendësimin dhe vendosjen e baterive, rast pas rasti pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë që do të marrin përsipër kryerjen e këtyre shërbimeve duhet të kenë një ambient pune (oficinë) për realizimin e këtyre shërbimeve ç'ka do të sillte detyrimisht realizimin me sukses të tyre.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryej shërbimin për zëvendësimin dhe vendosjen e baterive, si dhe shërbimin e transportit të baterive dhe dorëzimin e mallrave/ produkteve pranë magazinës së Bashkisë Tiranë si dhe nga magazina e Bashkisë Tiranë në mjedisin ku do të realizohet shërbimi me shpenzimet e tij.

Argumentimi: Referuar preventivit të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet zëvendësimin dhe vendosjen e baterive, rast pas rasti pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të deklarojnë marrjen përsipër për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe gjithashtu edhe marrjen përsipër të realizimit të transportit të tyre pranë ambjenteve të Bashkisë Tiranë pas kryerjes së shërbimeve si më sipër cituar.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë që disponon Licence për ushtrimin e veprimtarisë, lëshuar nga QKB, referuar Kodit VII.3.B.1.

Argumentimi: Kjo license është kërkuar duke marrë shkas nga llojet e shërbimeve që do të ofrohen dhe konform VKM Nr 538 dt 26.05.2009 për "Licencat edhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" (e ndryshuar). Kjo lloj license mbulon shërbimet si më poshtë vijon ndër të cilat përfshihen edhe shërbimet objekt prokurimi:

"Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove", me kodin VII.3.B.1, ku përfshihen:

a) riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

b) riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë së mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

- c) riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
- ç) riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;
- d) blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkiove;
- dh) mbledhja, depozitimi, shkatërrimi i mjeteve ose pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

2.3.5 Operatori ekonomik të jetë i pajisur me leje mjedisore Tipi C, kodi III.1 A

Argumentimi: “Leje e thjeshte mjedisore” me kodin III.1.A eshte kerkuar konform përcaktimeve të bëra në Lejet mjedisore të përcaktuara në 29 pika 1 e ligjit nr. Nr.10 431, datë 9.6.20 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që do të kryhet e, si dhe në mundësinë që ka kjo veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut.

Duke ju referuar DST- së kërkohet dhe montimi i gomave në automjetet përkatëse dhe për këtë arsye gomisteria/oficina duhet të jetë e paisur me leje mjedisore Tipi C LIGJ PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE Nr.10 463, datë 22.9.2011 Neni 3. Pika 30, “Mbetjet nga gomat e përdorura” janë mbetjet që krijohen kur gomat e vjetëruara, të dëmtuara janë zëvendësuar dhe kur automjetet arrijnë në fundin e jetës së tyre.

Kjo kërkesë është në proporcion me qëllimin e objektit të prokurimit. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Sipas ligjit të Prokurimit Publik në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi.

2.3.6 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë/ broshurë të baterive, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre (të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Në katalogë/ broshura duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) artikujt bateri dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 5 të DST. Katalogët/broshurat duhet të shoqërohen me një listë të baterive sipas tabelës së përgjithshme ku të specifikohen të dhënat si vijon:

Nr	Emërtimi i artikullit (bateri)	Njësia	Sasia	Emërtimi kompanisë prodhuese	Emërtimi i katalogut	Referenca, kodi i mallit	Numri i faqes në katalog	Standarti i Cilësisë ISO
----	--------------------------------	--------	-------	------------------------------	----------------------	--------------------------	--------------------------	--------------------------

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të pajisjeve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për pajisjet që propozon/oferton.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **deklaratë mbi garancinë e baterive** për jo më pak se 18 muaj nga dita e furnizimit, si dhe marrjen përsipër të zëvendësimit të baterive me defekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët gjatë zbatimit të kontratës, pas marrjes së njoftimit nga AK, Bashkia Tiranë. Operatori ekonomik duhet të deklarojë gjithashtu se do ta shoqërojë mallin me Certifikatën e garancisë së baterive në momentin e dorëzimit të tij tek autoriteti kontraktor pas lidhjes së kontratës.

***Argumentimi:** Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe të mbulojnë demtimet brenda periudhës së garancisë. Kriteri i kërkuar në lidhje me deklaratën, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standartin ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

***Argumentimi:** Kriteri për paraqitjen e ISO- 9001:2015 u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në baze të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Certifikatë duhet të jetë e lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të realizuar kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektit të kontratës.*

Kerkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit, në lidhje me cilësinë e produktit.

- ISO 9001:2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

Përmbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron manaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kategorizohen në kontratë. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë dhe mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i

lartë i menaxhimit për cilësi nga Operatori Ekonomik, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit, planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit/shërbimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

Shënim:

1. OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- *Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*
- *Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s’kualifikimi.*

2. PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT: Operatori ekonomik që do të ofertojë për më tepër se një Lot, duhet të zotërojë kapacitetet teknike, ekonomike dhe financiare sa shuma e loteve, për të cilat kanë ofertuar, të marra se bashku.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalentii tij/saj”.

Specifikime teknike: LOTI I: ”PJESË KËMBIMI GOMA”

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi

1. Gomat duhet të jenë të reja. Gomat nuk duhet të jenë të riveshura.
2. Të gjitha gomat duhet të jenë të prodhimit për përdorim 4 (katër) stinët, M+S stemë bore.
3. Në sipërfaqen anësorë të jashtme do të jenë të stampuara shkrimi i të dhënave
 - Prodhuesi (Marka)
 - Emërtimi i gomës
 - Përmasat (dimensionet) e gomës sipas porosisë të kërkuar dhe profili i batistratës
 - Indeksi i ngarkesës dhe i shpejtësisë
 - Struktura e gomës (radiale ose diagonale)
 - Tipi i gomës (tubeless/ Tube Type)
 - Numri i miratuar UN/ECE i prodhuesit të gomës. Kodi i prodhuesit të gomës që tregon se prodhimi i gomave bëhet në përputhje me rregullat e vendosura nga UN/ECE (e vendosur nga ata)
 - E (standarti i BE) ose DOT (standarti amerikan) Kodi i gomës (për shembull EA-Kodi i gomës **295/80 R 22.5**)
 - Data e prodhimit
4. Gomat do të jenë prodhim cilësor
5. Gomat e një dimesioni do të jenë e gjithë sasia e kërkuar e të njëjtit tip prodhimi/ të të njëjtës markë.
6. Gomat duhet të jenë prodhim vitit 2022
7. Gomat të paraqiten me katalog origjinal
8. Garancia e gomave:Garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 40000 (dyzetë mijë) km dhe gomat e motoçikletave jo më pak se 12000 km. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit osë cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë.

NR	PERSHKRIMI	PERMASA	INDEKSI
1	Goma	155/70 R13	75 T
2	Goma	165/65 R15	81 H
3	Goma	165/70 R13	75 T
4	Goma	185/60 R14	82 H
5	Goma	185/65 R14	86 T
6	Goma	195/55 R15	89 V
7	Goma	195/55 R16	87 H
8	Goma	195/65 R15	91 H
9	Goma	195/65 R16C	100 T
10	Goma	195/70 R15C	98 T
11	Goma	195/75 R16C	107 T
12	Goma	205 R14C	109 H
13	Goma	205 R16C	110/108 T
14	Goma	205/55 R15	91 V
15	Goma	205/55 R16	91 V
16	Goma	205/60 R16	92 H
17	Goma	205/65 R16C	107 T
18	Goma	205/70 R15C	106 H
19	Goma	205/75 R16C	106/104 R
20	Goma	205/80 R16	104 T
21	Goma	215/55 R17	94 V
22	Goma	215/60 R16	95 V
23	Goma	215/65 R16	104/106 T
24	Goma	215/75 R16C	116/114 R
25	Goma	215/75 R17,5	126/124 M
26	Goma	225/75 R17,5	126/124 M
27	Goma	235/45 R21	101 T
28	Goma	235/65 R17	104W
29	Goma	235/70 R16	106 H
30	Goma	245/45 R16	106 T
31	Goma	245/65 R17	111 H
32	Goma	245/70 R16	111 H
33	Goma	245/70 R17,5	136/134 M
34	Goma	255/40 R21	102 Y
35	Goma	255/70 R16	111 T
36	Goma	255/70 R22,5	112/110 S
37	Goma	265/70 R15	116 H
38	Goma	265/70 R16	112 H
39	Goma	265/75 R16	116 S
40	Goma	275/55 R20	110 H

41	Goma	285/70 R19,5	146/144 K
42	Goma	295/80 R22,5	112/110 S
43	Goma	305/70 R19,5	136/134 M
44	Goma	385/65 R22,5	112/110 H
45	Goma	3,00-10	S1 TL/TT
46	Goma	8,5 R17,5	156 G 154 K
47	Goma	9,0-R20	152/148L
48	Goma	10 R22	156 G 154
49	Goma	10 R22,5	152/148L
50	Goma	11 R22,5	146L, 140M
51	Goma	12 R22,5	152/148 L
52	Goma	12,5/80-18	14PR,NYLON 16PR
53	Goma	13 R22,5	156 G 154
54	Goma	16,9-28	14PR,NYLON 16PR
55	Goma	18.4-26	14PR,NYLON 16PR

SPECIFIKIMET LOTI II: "PJESË KËMBIMI BATERI"

- *Të jenë të prodhuara jo më shumë se gjashtë muaj nga dita e furnizimit.*
- *Të jenë prodhim sipas standarteve të C.E.*
- *Duhet të kenë bar kodin identifikues në etiketë, voltazhin 12V, Amperazhin, sipas specifikimeve të kërkuara në tabelë.*
- *Bateritë të jenë të plotësuara me solucion në rastin kur janë hermetike.*
- *Bateritë e thata (që kërkojnë mbushje me solucion) duhet të shoqërohen me sasinë e duhur të solucionit mbushës dhe ujit të distiluar (për plotësimin në nivelin e procesit të punës).*
- *Temperatura (-) 41 (+) 61*
- *Furnitori do të paraqesë një deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe afatit të përdorimit të baterive në kushte pune normale.*

Garancia e baterive për jo më pak se 18 muaj nga dita e furnizimit, si dhe marrjen përsipër të zëvendësimit të baterive me defekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët gjatë zbatimit të kontratës, pas marrjes së njoftimit nga AK, Bashkia Tiranë. Operatori ekonomik duhet të deklarojë gjithashtu se do ta shoqërojë mallin me çertifikatën e garancisë së baterive në momentin e dorëzimit të tij tek autoriteti kontraktor pas lidhjes së kontratës

Grafiku dhe afatet e lëvrimit:

Afatet e lëvrimit: Operatori fitues duhet të lëvrojë mallin për të dy lotet sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 30 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të marrë përsipër transportin e gomave

dhe baterive pranë magazinës së Bashkisë Tiranë si dhe nga magazina e Bashkisë Tiranë në mjedisin ku do të realizohet zëvendësimi i gomave dhe baterive me shpenzimet e tij. Operatori ekonomik do të shoqërohet nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë. Operatori ekonomik i shpallur fitues në ofertën ekonomike për goma dhe bateri duhet të përfshijë shërbimin për zëvendësimin dhe vendosjen e gomës dhe baterisë, balancimin e gomës dhe shërbimin e konvergencës.

Shërbimi duhet të kryhet brenda ditës nga marrja e njoftimit nga Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar të njësisë së prokurimit.

*Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“PJESË KËMBIMI GOMA DHE BATERI”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.*

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit;

Specifikimet teknike

NJËSIA E PROKURIMIT